



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:251119

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05136363

PPP. nr. 76/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të Kreditorit N.T.P “D...” nga Komuna Gllogocit, kundër debitorit M.Th nga Komuna Gllogocit, lidhur me borxhin në shumën prej **2,350.24 €**, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat Gj.R nën shenjën P. nr... të datës 06.10.2023, jashtë seancës me datën 27.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET** prapësimi i debitorit M.Th nga Komuna Gllogocit, ushtruar kundër urdhërit të Përmbaruesit Privat Gj.R nën shenjën P. nr... i datës 06.10.2023 me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit për përmbarimin e borxhit në shumën prej 2,350.24 €, ndërsa urdhëri i Përmbaruesit Privat P. Nr... i datës 06.10.2023 **mbetet në fuqi**.
- II.** Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi Urdhërohet që në afatin prej 7 ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës, të paguaj garancinë në gjykatë për shumën e plotë të kredisë prej 2,350.24 € .
- III.** Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese, tani debitor.

A r s y e t i m

Kreditori N.T.P “D...” ka parashtruar propozim tek Përmbaruesi Privat Gj.R për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr... të datës 10.06.2022 lidhur me pagesën e borxhit në lartësi prej 2,350.24 €, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Faturës Nr... të datës 10.06.2022 i cili është dokumenti i besueshëm e i cili sipas Nenit 21 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ndërsa në bazë të Nenit 29 par. 1.3 dhe 40 të këtij ligji është dokument i besueshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor duke u bazuar në Nenin 69 të LPP-së, me arsyetimin se: *propozimi ligjërish është i pa lejuar i pa bazuar dhe i mungon dokument i besueshëm se kur ne çfarë lartësie të borxhit mund të dërgohet lënda tek përmbaruesi, po ashtu kreditori nuk e ka shfrytëzuar asnjë mundësi mes tij dhe debitorit ngase u njëjti nëse do të kishte ndonjë obligim për të kryer tek kreditorit ka vepruar direkt në procedurë që është në dëm të debitorit, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 të LPP-së të aprovohet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat.*

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P. nr... të datës 06.10.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimin të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës gjykata e vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të besueshëm— Faturës me nr... e datës 10.06.2022 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga fatura si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmban dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të përmbarueshëm, janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 22, 29, 30, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimin janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm-faturë dhe më kërkesë që ka arritur për pagesë si borxh, ku në atë faturë shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj Kreditorit, gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim e debitorit pasi që nuk bazë ligjore lidhur me pretendimin e paraqitur në prapësim, ndërsa kreditori në anën tjetër, propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur Faturën me nr... e datës 10.06.2022 i cili si dokument i besueshëm i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i besueshëm në kuptim të Nenit 29 par. 1.3 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P. nr... të datës 06.10.2023, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së, ndërsa për të drejtën në ankesë si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimit gjykata vendosi në pajtim me Nenin 78 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 76/23, datë 27.12.2023

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.